

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1161/Prot.
1

Tiranë, më 23/12/2015

Lënda : Dërgohet Vendimi nr. 179, datë 23/12/2015, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Drejtuar: **Z.** _____
Zv/Kryeministër i Republikës së Shqipërisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

A
Ministër i Arsimit dhe Sportit
Rruga e Durrësit, nr.23, Tiranë

Z.1
Drejtoresh Ekzekutive
Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e PAK
Rr. : "Bogdani", nr.15, kati III-të, Tiranë.

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin nr. 179, datë 23.12.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi "ex officio" e çështjes së përjashtimit të disa prej kategorive të aftësisë së kufizuar, nga Vendimi i Këshillit të Ministrave të datës 22.07.2015 dhe Udhëzimi nr.29, datë 21.08.2015, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, lidhur me mosparashikimin e kuotave të pranimit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 17^q, Datë 23/2 2015

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në nenin 32, pika 1, germa c), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe bazuar në Urdhërin nr.139, datë 21.09.2015 ¹, filloi procedurën e shqyrtimit kryesisht të çështjes.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara², me shkresën e protokolluar pranë KMD-së me nr.775 prot., datë 10.09.2015, i drejtohet Komisionerit duke e informuar rreth problematikës si më poshtë sqarojmë:

Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit kanë miratuar respektivisht dy akte nënligjore dhe konkretisht:

1. Këshilli i Ministrave, ka miratuar më datë 22.07.2015 Vendimin “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në Programet e Studimeve të Ciklit të Parë, në Programet e Studimeve Jouniversitare Profesionale dhe në Programet e Integruara të Studimeve të Ciklit të Dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016”.

¹ Urdhër nr.139, datë 21.09.2015 “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes së kategorive me aftësi të kufizuar, të përjashtuara nga e drejta e përfitimit të kuotave të pranimit në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën FSHDPAK.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka miratuar Udhëzimin nr.29, datë 21.08.2015 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbërit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të institucioneve publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2015-2016”.

FSHDPAK përcjell shqetësimin se të dyja këto akte nënligjore nuk parashikojnë kuota pranimi për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, por vetëm për kategoritë e personave me aftësi të kufizuar që gëzojnë statusin e të verbërit dhe të paraplegjik/tetraplegjikut. Mungesa e parashikimeve ligjore për të përfituar nga mundësitë, përmes kuotave nxitëse të studimit për personat me aftësi të kufizuar që nuk kanë statuset e mësipërme ka sjellë diskriminimin e tyre në raport me kategoritë përfituese.

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar është shkak i cili gëzon mbrojtje nga ligji dhe bazuar në nenin 32/1/c të LMD-së³, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Qëllimi i këtij Ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike, duke rregulluar zbatimin e respektimin e parimit të barazisë, ndër të tjera në lidhje me gjendjen shëndetësore, aftësinë e kufizuar, ... ose me çdo shkak tjetër.

Parashikimet që bën ky Ligj, në nenin 3, pikat 1 dhe 2 të tij, lidhur me interpretimin e konceptit të diskriminimit, lejojnë që krahasimi të bëhet edhe midis kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Referuar sa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndjekur të gjithë hapat e parashikuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

³ Në vijim do t'i referohemi si shkurtesë për: Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“...“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr.862 prot, datë 14.10.2015 u njoftuan dhe ju kërkua informacion: Zv/Kryeministrit, , dhe Ministres së Arsimit dhe Sportit, duke i vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, si dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga FSHPAK.

Me shkresën me nr. 4892/1 Prot., datë 30.10.2015, Drejtorja e Kabinetit të Zëvendëskryeministrit, ia përcjell për kompetencë çështjen Drejtorit të Kabinetit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën me nr.8262/1 prot., datë 10.11.2015, bën me dije Komisionerin se:



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

“E drejta për arsim në lidhje me personat me aftësi të kufizuar në statusin e të verbërit dhe të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë është e përcaktuar në ligje të veçanta.

Neni 8, i Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar, përcakton se:
“...Arsimi i të verbëve në sistemin shtetëror bëhet falas, kurse pranimi i tyre në arsimin e zakonshëm bëhet me kriterë të veçanta të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjatë kohës së studimit në arsimin e mesëm, universitar ose pasuniversitar, si dhe gjatë periudhës së kualifikimit, të verbërit përfitojnë pagesën e vendosur nga Këshilli i Ministrave. Ata me gradë shkencore këtë pagesë e përfitojnë në mënyrë të përhershme. Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e të verbëve”.

Nenet 3 dhe 8, të Ligjit nr.8626, datë 22.06.200 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, përcaktojnë se: “...3. Shteti krijon kushte për të sëmuret paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive”, si dhe “...8. Shteti favorizon arsimimin e të sëmurve paraplegjikë në shkollat e larta të sistemit shtetëror. KM merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe të institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”.

MAS⁴ në vijim të përgjigjes argumenton se: “Me Vendimin nr.638, datë 22.07.2015 të KM-së, kategorive të cituara në vendim, u jepet një shans nëpërmjet aplikimit me kuota të përcaktuara për këto kategori për realizimin e mundësisë së shkollimit të tyre universitar, që në këto kushte dhe për shkak të paaftësisë së tyre fizike nuk do të mund të arrinin rezultate për t’u kualifikuar për vazhdimin e studimeve të larta”.

Nga ana tjetër, MAS shprehet se: “...sa i takon propozimeve të bëra për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, MAS është udhëhequr nga parimi i mos diskriminimit, jo vetëm për kategoritë me nevoja të veçanta, por për të gjithë studentët e tjerë. Akordimi i kuotave,

⁴ MAS i referohemi si shkurtesë për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

në kushtet kur kapacitetet pritëse të universiteteve janë të limituara, domosdoshmërisht ul numrin e kuotave në dispozicion për kandidatët për studentë, të cilët aplikojnë në bazë të meritës dhe që nuk janë pjesë e kategorive të veçanta. Pra, akordimi i kuotave të këtyre kategorive është bërë duke marrë në konsideratë, përveç kuadrit ligjor përkatës, edhe një sërë faktorësh, për të ruajtur një balancë në krijimin e aksesit individëve që për shkak të shkallës së aftësisë së kufizuar nuk kanë arritur të kenë rezultate si bashkëmoshatarët e tyre, për të mundësuar aplikimin e këtyre kategorive në kushte relativisht të barabarta me kandidatët e tjerë për studentë, të cilët aplikojnë bazuar në sistemin Meritë-Preferencë, duke konsideruar se edhe në mes tyre ka individë që për shkak të vështirësive familjare mund të mos kenë patur mundësi të njëjta studimi dhe arritje rezultatesh në arsimimin e tyre të mëparshëm”.

Gjithashtu, MAS thekson faktin se kjo praktikë është ndjekur edhe në vendimet respektive të viteve pararendëse akademike për përcaktimin e kuotave në raport me kategoritë e veçanta, duke mos patur ndonjë kundërshtim nga Ministrinë e linjës, përfshirë edhe Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Përsa më sipër, pas marrjes së informacionit nga FSHDPAK, Komisioneri analizoi parashikimet e bëra në dy aktet nënligjore: VKM në nr. 638, datë 22.07.2015 “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016” dhe Udhëzimin nr.29, datë 21.08.2015 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbërit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të institucioneve publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2015-2016”, si dhe përgjigjen shkresore të MAS, parë kjo në kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe atë vendas.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

Ekziston një legjislacion i tërë dhe akte nënligjore, politika dhe strategji, ku parashikohen detyrime për të gjithë institucionet e përfshira në procesin e arsimit.

- E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila po ashtu gëzon një mbrojtje të posaçme nga Konventa e OKB-së “Për të drejtat e PAK”.
- Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në nenin 1 të saj përcakton se: “... *Qëllimi i konventës është të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë gëzimin e plotë e të barabartë të të gjithë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut prej personave me aftësi të kufizuara*”.

Po në këtë Konventë, përcaktohet se: “...*personat me aftësi të kufizuar janë të gjithë personat që vuajnë nga një aftësi e kufizuar afatgjatë fizike, mendore, intelektualë, apo ndjesore e cila duke pasur parasysh qëndrimet e ndryshme negative apo pengesat fizike, mund t’i pengojë këto persona për t’u përfshirë plotësisht në shoqëri*”.

Referuar nenit 24/1 të kësaj konvente, përcaktohet se: “*Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për arsim. Me qëllim realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, Shtetet Palë garantojnë një sistem arsimor përfshirës në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe arsimin e lartë gjatë gjithë jetës*”.

Po kështu, neni 24/5 thekson se: “*Shtetet Palë do të garantojnë që personat me aftësi të kufizuar të jenë në gjendje të kenë akses në arsimin e lartë, trainime profesionale, arsimin për të rritur dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët. Për këtë qëllim, Shtetet Palë do të garantojnë ofrimin e akomodimit të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar*”.

Pra, Konventa nuk bën përjashtime mes kategorive të aftësisë së kufizuar, kur bëhet fjalë për gëzimin e të drejtave në mënyrë të barabartë.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

- Referuar parashikimeve ligjore të bëra në Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 4⁵, pika 3 dhe 4 të tij, përcaktohet se: “3....Arsimi u garantohet në programet e studimit edhe individëve, të cilëve u njihet kjo e drejtë me ligje të veçanta. 4.Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore për përcaktimin e kategorive të individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë... ”.
- Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁶, në nenin 1, të tij rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë,.....aftësinë e kufizuar,ose çdo shkak tjetër” dhe qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike, në qasje me sa parashikohet prej tij.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit është një nga fushat e veçanta që gëzojnë mbrojtje nga LMD, i cili parashikon masa pozitive për këtë kategori personash. LMD në nenin 11 të tij, parashikon se: “ Masa e përkohshme, e veçantë që synon përsheptimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë së shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”. Në këtë kuadër, neni 18 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “Detyrat e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrit të Arsimit dhe Sportit” , në pikën 2, germa c) parashikon se: “...Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Sportit, ndër të tjera, marrin secili masa për: ...c) arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuar, si dhe të personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji.” Parashikimet që bën LMD në lidhje me konceptin e diskriminimit, respektivisht në nenin 3, pika 1⁷ e tij, lejon që krahasimi të bëhet edhe midis kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

⁵ Neni 4 “E drejta për arsimim”

⁶ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

⁷ “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij Ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e



- Ligji nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, rregullon konceptin e “aftësisë së kufizuar” dhe është i harmonizuar me frymën që përcjell Konventa e OKB-së “Për të drejtat e PAK”. Të dyja këto akte ligjore, nuk bëjnë dallime midis aftësive të kufizuara. Ligji nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, ka të njëjtën qasje, duke mos bërë dallime mes grupimeve, por duke u fokusuar në vlerësimin e individualizuar të nevojave të çdo grupimi apo individi brenda grupimit.
- Ligjin nr.9355/2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar, përcakton se: “...PAK janë individët të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko-mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme ose të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin”.

Referuar sa më sipër:

- Vlerësojmë marrjen e masave pozitive që nxisin rritjen e përfitimeve të kategorisë së para/tetraplegjikëve dhe të verbërve, në mënyrë që të ngushtohet hendeku mes kategorive të përcaktuara si PAK dhe personave të tjerë që nuk e kanë këtë status. E njëjta frymë duhet të ekzistojë edhe përsa i takon nxitjes së arsimimit të kategorive të tjera PAK.
- MAS nuk ka ndjekur dhe zbatuar parimin e trajtimit të barabartë brenda grupimeve të të njëjtave kategori të aftësisë së kufizuar (referuar personave me aftësi të kufizuar, që janë deklaruar të tillë me vendim të Komisioneve Mjekësore për Caktimin e Aftësisë për Punë, por që nuk janë të verbër apo paraplegjik/tetraplegjik). Për kategoritë e personave të verbër apo paraplegjik/tetraplegjik, me ligje specifike ka një garantim të të drejtave të tyre në fushën e legjislacionit, sikundër edhe në atë të arsimit. Sikundër shprehet qartë nga përgjigja e MAS, në Udhëzimin e tyre janë përfshirë kategoritë e përcaktuara në bazë të nenit 8, të Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar, si dhe nenit 3 dhe 8, të Ligjit nr.8626, datë 22.06.200 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar. (respektivisht si më sipërcituar). Ndërkaq,

lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, si dhe me ligjet në fuqi.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

kategoritë e tjera të aftësisë së kufizuar, pavarësisht se legjislacioni shqiptar i përcakton si përfitues të kategorisë PAK, janë lënë jashtë politikave gjithëpërfshirëse, referuar në këtë rast fushës së arsimit, duke mos patur kuota të parashikuara për ta, për t'u përzgjedhur dhe regjistruar në programet e Ciklit të Parë të Studimeve me Kohë të Plotë, në Programet e Studimeve Jouniversitare Profesionale si dhe në programet e integruara të Ciklit të Dytë në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2015-2016.

- Komisioneri konstaton se kategoria e personave me aftësi të kufizuar, që janë deklaruar të tillë me vendim të Komisioneve Mjekësore për Caktimin e Aftësisë për Punë, por që nuk janë të verbër apo paraplegjik/tetraplegjik, janë vënë në pozita jo të favorshme krahasuar me kategorinë e personave të verbër apo paraplegjik/tetraplegjik, duke iu mohuar atyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë mundësinë për të ndjekur arsimin e lartë publik, përmes përfitimit të kuotave nxitëse. MAS nuk ka vënë në dispozicion asnjë informacion që vërteton se marrja e masave pozitive të mësipërme ka qenë rezultat i vlerësimit të nevojave që kanë grupet e ndryshme brenda aftësisë së kufizuar apo të një analize mbi përfitimin e secilës kategori. Nuk është analizuar dhe vlerësuar fakti i diferencimit në trajtim të secilës kategori deri në këtë moment.
- Neni 7, pika 1, e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikon se: "*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*". Konstatojmë se, pavarësisht vënjes në dijeni të këtij pretendimi, MAS ka kthyer një përgjigje skematike dhe nuk e ka analizuar aspak atë duke marrë në konsideratë efektet pozitive që do të kishte marrja e masave pozitive që nxisin arsimimin edhe të kategorive të tjera të PAK dhe të drejtën e tyre për të gëzuar në mënyrë të barabartë dhe pa u diskriminuar të drejtën për arsim.
- Përfundimi nga kjo e drejtë e gëzimit të përfitimit nga kuotat nxitëse i personave PAK(përveç kategorive: të verbër dhe paraplegjikë/tetraplegjikë), i privon ata nga ndjekja

e arsimit të lartë, duke u bërë pengesë në integrimin e tyre në shoqëri dhe sigurimin e një profesioni prej tyre, i cili do t'u garantonte një të ardhme më të mirë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), c) nenin 3, pika 1 dhe 3, nenin 7, pika 1, nenin 18, pika 1 dhe 2, dhe, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, nga ana e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, përcaktuar me vendim të KMCAP-së dhe në bazë të Ligjit nr.9355/2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, përveç dy kategorive të përfshira tashmë, të personave të verbër apo paraplegjik/tetraplegjik.
2. Këshilli i Ministrave dhe Ministra e Arsimit dhe Sportit të marrin masa dhe të bëjnë parashikimet e duhura ligjore, për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, të përcaktuar si të tillë me vendim të KMCAP-së dhe në bazë të Ligjit nr.9355/2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë kategoritë e PAK, në fushën e arsimit; në përzgjedhjen dhe regjistrimin në programet e Ciklit të Parë të Studimeve me Kohë të Plotë, në Programet e Integruara të Ciklit të Dytë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, si dhe në Programet e studimeve Jouniversitare Profesionale, për vitin akademik 2015-2016.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU



Handwritten signature

Date: 26/11/2015



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al